



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA GRAMSH**  
**KRYETARI**

Nr. 3104 / prot.

Gramsh, më 23/08/2021

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion

**Drejtuar: PARTNERS ALBANIA**

**Tiranë**

*Tënderuar,*

Në përgjigje të shkresës tuaj me datë 13.07.2021, regjistruar në Bashki me nr.3104 prot., datë 17.08.2021, ju dërgojmë informacionin e kërkuar:

1. A keni në institucionin tuaj struktura përgjegjëse për politikat rimore në organigramën e institucionit? Nëse po, në cfarë forme janë ato dhe prej sa kohësh?
  - Në bashkinë Gramsh, prej dy vjetësh tashmë, janë ngritur strukturat përgjegjëse për politikat rimore. Në këtë moment kjo strukturë është në nivel specialisti.
2. Nëse nuk keni ende struktura të tillë, ju lutem a mund të tregoni arsyen përsë?
  - E kemi një strukturë të tillë.
3. A ka pranë institucionit tuaj struktura përfaqësuese këshillimore rimore si Borde Rimore, Komisione Rimore, Këshill Rimore?
  - Po, në Bashkisë Gramsh është ngritur Këshilli Rimore.
4. Nëse po, keni dijeni mbi institucionin/organizatën/individin që ka ndërmarrë nismën për krijimin e strukturës përfaqësuese dhe në cfarë forme bashkëpunoni me to?
  - Nismën për krijimin e Këshillit Rimore e ka ndërmarrë vet bashkia. Bashkia Gramsh ka komunikim dhe ndërveprim shumë të mirë me strukturat e Këshillit Rimore, i mirëpret kërkuesat/sygjerimet e tij dhe i reflekton ato aty ku është e mundur.
5. A ka pranë bashkisë tuaj një Qendër Rimore ose hapësira të dedikuara grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç dhe cilat janë ato?
  - Në vitin 2019 rikonstruktuan Këndin Sportiv, një hapësirë e cila shfrytëzohet nga të rinjtë për veprimitari sportive.
  - Aktualisht po rikonstruktojmë Pallatin e Sportit për të krijuar hapësira të përshtatshme për të rinjtë e apasionuar pas sporteve me dorë dhe për t'i afuar të rinjtë më pranë aktivitetave sportive.
  - Njëkohësisht e kemi në plan ndërtimin e një qendre multifunksionale për të rinjtë dhe kemi aplikuar në një thirrje që është hapur nga Agjensia Kombëtare e Rinisë, për financimin e saj.
6. A keni ju pranë institucionit tuaj buxhet vjetor të planifikuar për grupmoshën 15-29 vjeç? Nëse po në cilat zëra konkretë janë këto planifikime dhe sa përqind të shumës totale të

buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë?

- Bashkia Gramsh akordon një pagë specialisti cdo muaj, në kuadër të rinishë së bashkisë Gramsh. Gjithashtu ka kryer investime për rinishë si: Këndi Sportiv apo Pallati i Sportit. Cdo miniprojekt që Këshilli Rinor ka pasur dëshirë të implementojë (projekte të vogla komunitare), Bashkia Grmash i ka mbështetur me të ardhurat e veta. Pra, edhe pse nuk kemi një zë të veçantë buxheti për të rinjtë, të rinjtë e Bashkisë Gramsh kanë pasur mbështetje financiare të vazhdueshme nga bashkia.

7. A ka në institucionin tuaj politika të zhvilluara specifisht për grupmoshën 15-29 vjeç? Nëse po a mund të na dërgoni një kopje? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë?
- Jo, Bashkia Gramsh nuk ka një strategji për zhvillimin e rinishë. Me burimet e veta njerëzore bazhka nuk mund të hartojë dot një strategji për të rinjtë. Kemi pasur marrëveshje me një organizatë rimore për një projekt me të rinjtë e Gramshit dhe gjatë këtij projekti zhvilluan disa bisedime për hartimin e strategjisë për të rinjtë, por kjo nuk u realizua dot për mungesë burimesh financiare.
8. A ka të punësuar pranë institucionit tuaj individë të moshës 18-29 vjeç dhe nëse po sa është përqindja e tyre krahasuar me numrin total të administratës?
- Po, në Bashkinë Gramsh kemi 23 të punësuar në grupmoshën 18-29 vjeç, e cila përkthehet në 6 % e të punësuarve.
9. A keni pasur ju forma të bashkëpunimit me grupe të rinjsh, organizata rimore etj. në kuadër të shërbimeve publike, aktivitete lokale, fushata ndërgjegjësimi, debateve publikë, fushata online apo nisma të tjera? Nëse po, ku kanë konsistuar ato?
- Bashkia Gramsh ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Këshillin Rinor, për implementimin e nismave komunitare si: pastrim ambientesh publike, mbjellje pemësh, një ditë me të moshuarit, fushata ndërgjegjësimi kundër dhunës, bullizmit, emigracionit të jashtligjshëm, festave lokale dhe në kuadër të implementimit të projekteve të ndryshme sic ishte "Moinitorimi i shërbimit të pastrimit", e cila konsistonte në një nisëm ku vet të rinjtë duhet të raportonin mbi gjendjen e koshave të mbeturinave, pastërtisë së parqeve, cilësinë e tualetave publike dhe atyre nëpër shkolla etj.
10. Sa është me përafërsi pjesëmarra e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese?
- Pjesëmarra e të rinjve në konsultimet publike që zhvillon bashkia përgjithësisht nuk mungon, megjithatë nuk është në nivele të larta. Pavarsisht thirrjeve që bashkia i bën të rinjve për zhvillimin e dëgjesave publike, një numër i vogël të rinjsh janë të interesuar dhe marrin pjesë në këto dëgjesa. Për të pasur edhe feedback-un e të rinjve, bashkia organizon një mbledhje të veçantë me të rinjtë dhe evidenton problematikat dhe nevojat e tyre, për t'i reflektojtar më pas në dokumentin e buxhetit.

Punë të mbarë dhe gjithë të mirat!

Me konsideratë,

Konc/Dakt: E. Kaso  
Afati: \_\_\_\_\_  
Dosja: \_\_\_\_\_



Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku", Email: bashkia.gramsh2017@gmail.com